

Nr: 10-130

Shkup:

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 10, nenit 15 paragrafi (5), nenit 16 paragrafi (2) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10), dhe nenit 28 paragrafi (10) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas Njoftimit për dhënien e planifikuar të ndihmës, të dorëzuar nga Ministria e Financave nr. 15-8036/2 të datës 17.09.2024, në seancën e mbajtur më 23.09.2024, mori këtë

AKTVENDIM

Për vlerësimin e lejueshmërisë së dhënies së ndihmës shtetërore nga Ministria e Financave ndaj Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore.

Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për detyrimet sipas Marrëveshjes Financiare të destinuar për financimin e projektit "Interkonektori për transmetimin e gazit natyror Greqi-Maqedoni e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut", që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore, përbën **ndihmë shtetërore** në kuptimin e nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, e cila si **ndihmë individuale** në kuptimin e nenit 4 paragrafi (1) pika 2) e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore jepet nga Ministria e Financave dhe dhënia e saj është **e lejuar** në përputhje me nenin 8 paragrafi (2) pika b) e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore sepse bëhet fjalë për ndihmë të destinuar për avancimin e realizimit të projekteve me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë.

Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore (në tekstin e mëtejshëm "Ligji"), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm "KMK") është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të ndihmës shtetërore. Çdo dhënës i ndihmës shtetërore, i definuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit, është i detyruar, në përputhje me nenin 13 paragrafi (1) të Ligjit, t'i dorëzojë KMK-së njoftim për çdo plan për dhënien e ndihmës së re ose ndryshimin e ndihmës ekzistuese shtetërore, pavarësisht nëse ajo jepet si ndihmë individuale apo si skemë ndihme.

KMK-së, nga një person i interesuar, i është dorëzuar një kërkesë për shqyrtimin e ekzistencës eventuale të ndihmës shtetërore të paligjshme në lidhje me Ligjin për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për detyrimet sipas marrëveshjes financiare të destinuar për financimin e projektit "Interkonektori për transmetimin e gazit natyror Greqi-Maqedoni e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut", që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore.

Në përputhje me nenin 10, nenin 11 paragrafi (1), nenin 15 paragrafi (4) dhe nenin 18 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, më 05.07.2023 Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës solli Konkluzionin nr. 10-56 për fillimin e procedurës për vlerësimin e lejuarshmërisë së dhënies së ndihmës shtetërore nga Ministria e Financave në bazë të Ligjit për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për detyrimet sipas marrëveshjes financiare të destinuar për financimin e projektit "Interkonektori për transmetimin e gazit natyror Greqi-Maqedoni e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut", që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore.

Për këtë qëllim, KMK në Konkluzionin nr.10-56 të datës 05.07.2023 e detyroi Ministrinë e Financave të dorëzonte të gjitha të dhënat e nevojshme për vlerësimin e ndihmës nga ana e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Ministria e Financave më 10.08.2023 me shkresën nr. 15-8109/2 të datës 03.08.2023, në përputhje me detyrimin nga ana e KMK-së që rezultoi nga Konkluzioni nr.10-56 i datës 05.07.2023, dorëzoi dokumentacionin e kërkuar në KMK.

Në përputhje me nenin 15 paragrafi (5) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, pas përfundimit të procedurës për vlerësimin e lejueshmërisë së dhënies së ndihmës shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës merr Vendim.

Në lidhje me Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për detyrimet sipas Marrëveshjes Financiare të destinuar për financimin e projektit "Interkonektori për transmetimin e gazit natyror Greqi-Maqedoni e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut", që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore (në tekstin e mëtejshëm: Projektligji), Ministria e Financave me shkresën nr. 15-8036/2 të datës 17.09.2024 (Numri ynë 10-130 i datës 17.09.2024) dorëzoi Njoftim për garancinë që i jepet Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore (në tekstin e mëtejshëm: NOMAGAS) nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Ministrisë së Financave në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës ekzistuese shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/11).

Bashkëngjitur Njoftimit me shkresën nr. 15-8036/2 të datës 17.09.2024 nga ana e Ministrisë së Financave u dorëzuan Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për detyrimet sipas Marrëveshjes Financiare të destinuar për financimin e projektit "Interkonektori për transmetimin e gazit natyror Greqi - Maqedoni e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut", që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore, Amendamenti nr.1 i Marrëveshjes Financiare që duhet të lidhet ndërmjet Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore dhe Bankës Evropiane të Investimeve, Amendamenti nr.1 i Marrëveshjes së Garancisë që duhet të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane të Investimeve, Amendamenti nr.1 i Marrëveshjes së Grantit që duhet të lidhet ndërmjet Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, Bankës Evropiane të Investimeve dhe Ministrisë së

Çështjeve Evropiane, Bilanci i gjendjes (Raporti për gjendjen financiare më 30.06.2024) i Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, Bilanci i suksesit (Raporti për fitimin ose humbjen për periudhën 01.01 deri 30.06.2024) i Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, Fleta përfundimtare - kartela analitike e Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, dhe Lista e punonjësve të Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore.

Konkretisht, në nenin 1 të Projektligjit theksohet se në titullin e Ligjit fjalët "Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore" zëvendësohen me fjalët "Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore". Gjithashtu, në nenin 2 të Projektligjit theksohet se në të gjithë tekstin e Ligjit fjalët "Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore" zëvendësohen me fjalët "Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore".

Për këtë qëllim, u miratuan Marrëveshja për ndryshim statusor-bashkim i NER SHA Shkup dhe GAMA SHA Shkup, me themelimin e NOMAGAS SHA Shkup me Akt Noterial ODU nr. 611/22 tek noteria e autorizuar nga Shkupi, Ana Dojčinovska më 01.07.2022 për Marrëveshjen për bashkimin e shoqërive tregtare si dhe Statuti i NOMAGAS SHA Shkup ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 281/22 dhe nr.202/23). Në nenin 2 të Statutit të NOMAGAS SHA Shkup theksohet se Shoqëria krijohet me ndryshim statusor-bashkim të NER SHA Shkup dhe GA-MA SHA Shkup, si dhe se Shoqëria është pasardhëse ligjore e NER SHA Shkup dhe GA-MA SHA Shkup. Shoqëria themelohet nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

KMK vlerësoi se Njoftimi i dorëzuar nga Ministria e Financave është rregullt dhe përmban të gjitha të dhënat e parashikuara në nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit, respektivisht se një njoftim i tillë për nga forma dhe përmbajtja është në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës ekzistuese shtetërore (në tekstin e mëtejshëm "Rregullorja").

KMK gjatë shqyrtimit të njoftimit konstatoi gjendjen faktike si vijon:

- **Dhënës i ndihmës shtetërore është:** Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Financave
- **Përfitues i ndihmës shtetërore është** Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore
- **Baza ligjore për dhënien e ndihmës shtetërore** është akti juridik në bazë të të cilit jepet ndihma – Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për detyrimet sipas Marrëveshjes Financiare të destinuar për financimin e projektit "Interkonektori për transmetimin e gazit natyror Greqi - Maqedoni e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut", që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore, Amendamenti nr.1 i Marrëveshjes Financiare që duhet të lidhet ndërmjet Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore dhe Bankës Evropiane të Investimeve,

Amendamenti nr.1 i Marrëveshjes së Garancisë që duhet të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane të Investimeve dhe Amendamenti nr.1 i Marrëveshjes së Grantit që duhet të lidhet ndërmjet Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, Bankës Evropiane të Investimeve dhe Ministrisë së Çështjeve Evropiane.

Për të përcaktuar nëse një masë e ndërmarrë nga dhënësit e ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore, vlerësohet përmbushja kumulative e katër kritereve të mëposhtme:

- masa e tillë të përfshijë një shpenzim potencial ose të realizuar të mjeteve shtetërore;
- të jetë selektive;
- të përbëjë një përfitim ekonomik për marrësin dhe
- të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti.

Sipas KMK-së, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, jep ndihmë shtetërore në formën e një garancie individuale për Shoqërinë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore.

KMK konstatoi se Projektligji përbën ndihmë shtetërore për faktin se:

- përfshin një shpenzim potencial të mjeteve shtetërore pasi në nenin 1 të Projektligjit parashikohet se Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes Financiare të destinuar për financimin e projektit "Interkonektori për transmetimin e gazit natyror Greqi - Maqedoni e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut", e lidhur ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, në vlerë deri në 28.900.000 euro, nëse Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore nuk i përmbush dhe nuk i shërben detyrimet nga Marrëveshja Financiare.
- selektiviteti shihet në faktin e përcaktimit të vetëm një operatori ekonomik - Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore i cili merr garancinë;
- përbën një përfitim për marrësin pasi me ndihmën shtetërore të dhënë i mundësohet një avantazh ekonomik në treg krahasuar me konkurrentët e tjerë që nuk do të marrin një ndihmë të tillë dhe
- një ndihmë e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti sepse shkel ose mund të shkelë konkurrencën duke i mundësuar një avantazh ekonomik Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore.

Në këtë rast, gjatë shqyrtimit të lejueshmërisë së dhënies së ndihmës shtetërore, dhe në përputhje me nenin 3 paragrafi (3) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, KMK zbaton Njoftimin e Komisionit Evropian për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore në formën e garancive (Commission Notice on the application of Articles 87 and 88 of the EC Treaty to State aid in the form of guarantees – EUR-Lex – 52008XC0620(02) - në tekstin e mëtejshëm Njoftimi).

Vlerësimi i ndihmës shtetërore nga KMK bazohet në pikën 3.2 të Njoftimit (garancitë individuale).

Në këtë pikë, përmes përmbushjes së kushteve të caktuara, tregohet se si përcaktohet nëse ekziston apo nuk ekziston ndihma shtetërore në garancinë e lëshuar. Përmbushja e kushteve të përmendura në pikën 3.2. të Njoftimit nuk nënkupton ndihmë shtetërore për garancinë shtetërore të dhënë, nëse: a) ndërmarrja nuk është në vështirësi financiare; b) vëllimi i garancisë mund të matet saktësisht në momentin kur jepet (garancia duhet të jetë e lidhur me një transaksion specifik financiar, për një shumë maksimale fikse dhe e kufizuar në kohë); c) garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huas së pashlyer ose mjeteve të tjera financiare (ndërsa borxhi zvogëlohet dhe garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huas së pashlyer ose detyrimit financiar), me përjashtim për ndërmarrjet që ofrojnë shërbime të interesit ekonomik të përgjithshëm dhe d) garancia e dhënë duhet të kompensohet me një premi të përshtatshëm.

Duke marrë parasysh faktin se në këtë rast nuk janë plotësuar dy kushtet e fundit, KMK vlerëson se në këtë rast bëhet fjalë për ndihmë shtetërore në kuptimin e nenit 5 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Në Njoftim është theksuar se Projekti "Interkonektori për transmetimin e gazit natyror Greqi - Maqedoni e Veriut, pjesa e Maqedonisë së Veriut" është me rëndësi strategjike për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Projekti përfshin ndërtimin e interkonektorit për transmetimin e gazit natyror me Greqinë. Projekti është një nga projektet më prioritare për Republikën e Maqedonisë së Veriut, për rajonin, si dhe për Komunitetin e Energjisë dhe i njëjti është mbështetur nga të gjitha institucionet relevante evropiane.

Implementimi i projektit do të kontribuojë në sigurimin e një rritjeje ekonomike të shpejtë dhe të qëndrueshme, një standard më të lartë jetese dhe cilësi jete për qytetarët. Projekti do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të rajonit dhe bashkëpunimin energjetik rajonal.

Duke marrë parasysh faktin se në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka shumë ndotje të lartë të ajrit për shkak të djegies së drurit, naftës dhe mbeturinave për ngrohje, përfitimet nga futja e gazit natyror mund të shihen edhe përmes avancimit dhe mbrojtjes së mjedisit me një përdorim më të madh të gazit natyror si energjent i pastër ekologjik.

Republika e Maqedonisë së Veriut është një vend që deri më tani mbështetet në lëndë djegëse të ngurta me një gamë të gjerë përdorimi të energjisë dhe kryesisht ngrohje dhe prodhim të energjisë elektrike. Rezultati është prodhim i lartë i dioksidit të karbonit.

Në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gazi natyror përbën një energjent tranzit drejt energjisë së gjelbër dhe disponueshmëria e tij më e gjerë është një kontribut në zhvillimin e energjisë së gjelbër.

Realizimi i projektit përfshin ndërtimin e një gazsjellësi kryesor për transmetimin e gazit natyror për lidhjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Republikën e Greqisë, gjë që do të mundësojë sigurimin e sasive shtesë nga një burim tjetër i furnizimit me gaz natyror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, diversifikimin, sigurinë e furnizimit dhe mundësinë e uljes së çmimit të importit të gazit natyror, pasi do të sigurohet disponueshmëria e gazit natyror nga disa burime të ndryshme të gazit natyror.

Ky projekt është parashikuar në dokumentet strategjike:

- Programi i Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2024-2028,
- Lista unike e projekteve prioritare, e miratuar nga Qeveria më 30.05.2024 dhe
- Programi i Reformave Ekonomike 2024 – 2026

Përveç kësaj, projekti mbështetet nga Komisioni Evropian, kështu që i njëjti është përgatitur me ndihmën teknike nga BE - CONECTA, ndërsa në dhjetor 2020, në kuadër të instrumentit të BE-së Kuadri Investues për Ballkanin Perëndimor - WBIF u siguruan 12.724.000 euro grant WBIF (9.900.000 euro grant investimi, 2.475.000 euro grant për mbështetje teknike, 50.000 euro për komunikim dhe dukshmëri të projektit dhe 299.000 euro komision për menaxhim për BEI). Më 22.12.2021 u lidh Marrëveshja e Grantit ndërmjet Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Kombëtare Energjetike Shkup, në pronësi shtetërore (tani Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore), Bankës Evropiane të Investimeve dhe Sekretariatit për Çështjet Evropiane (tani Ministria e Çështjeve Evropiane).

Nga sa u tha më lart, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës konkludoi se Projektligji përbën ndihmë shtetërore në kuptimin e nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për faktin se një ndihmë e tillë e dhënë nënkupton shpenzim shtetëror dhe ajo shkel ose mund të shkelë konkurrencën duke i mundësuar një avantazh ekonomik një ndërmarrjeje të caktuar që nuk do të ishte e mundur pa ndihmën shtetërore të dhënë ose përmes favorizimit të prodhimit të mallrave të caktuara ose ofrimit të shërbimeve të caktuara. Kjo ndihmë shtetërore e dhënë nga Ministria e Financave është e lejuar në kuptimin e nenit 8 paragrafi (2) pika b) e Ligjit, pasi bëhet fjalë për ndihmë të destinuar për avancimin e realizimit të projekteve me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë.

Për shkak të lartpërmendurës, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Në përputhje me nenin 26 paragrafi (3) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, padia nuk e shtyn zbatimin e vendimit, përveç në rastin kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës urdhëron kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ose të keqpërdorur, dhënia e së cilës nuk është e lejuar.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.